



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 417/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Arsyetim

Me datë 27.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në të cilën thekson se në QV 2501Y/09R është bërë gabim pasi që parashtresë i ankesës thekson se kandidati me nr 74 ka 26 votat ndërsa në FRK kandidati me nr 03 ka 87 e në shënimet e komisionarëve ka 7 vota, ndërsa kandidatin me nr 6 i janë shënuar 83 vota ndërsa në FRK janë 2 vota.

Bazuar në nenin 117.2 të LZP-së PZAP-i *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”*

PZAP-i pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri hetimin gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik LDK dhe në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon se votat e tij i mungojnë dhe se nuk janë regjistruar në FRK.

PZAP-i ka gjetur se në FRK janë të shënuara 26 vota lidhur me vendvotimin 2501Y/09R e jo siç pretendohet në ankesë se nuk është shënuar asnjë votë. Kjo konstatohet nga FRK-ja origjinale të cilën PZAP-i një kopje ka marrë për shqyrtim të mëtutjeshëm

Lidhur me rastin konkret nuk kanë qenë e nevojshme të hapet kutia e votimit me qenë se votat e kontestuara nga parashtruesi i ankesës gjenden në FRK-në origjinale në QNR.

Andaj pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë për mungesë të votave dhe shënimit të tyre në FRK janë të pabazuara.

PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 417/2014 më datën 30.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.